



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:012196

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05424390

PKR.nr.16/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti për Krime të Rënda, kryetarja e trupit gjykues Ajser Skenderi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Floridin Osmanaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit D. S., nga Prizreni ku edhe banon në rr. “.....” nr., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.3/2024 të datës 01.03.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datën 07.03.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit, Mehdi Sefa, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. A.P.; më datën 07.03.2024, morri dhe e shpalli, ndërsa me datën 11.03.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari

D. S., nga i ati dhe e ëmae lindur S., i lindur me datë, në Prizren, ku edhe tani jeton në Rr.”” nr., e ka të kryer shkollën e mesme, me profesion shofer, i pamartuar i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personalshqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim prej datës 11.01.2024.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 11.01.2024 rreth orës 19:30 minuta në Prizren pa autorizim posedon me qëllim të shitjes substanca narkotike të llojit kokain dhe marihuanë në atë mënyrë që gjersa ishte duke e drejtuar automjetin “.....” ngjyrë hiri me targa në magjistrale Prizren-Suharekë te semaforat në lagjen “Dardania” është ndaluar automjeti për kontroll, ashtu gjatë kontrollimit në mes të ulëseve është gjetur një qese plastike me substancë narkotike të llojit kokainë në peshë 0.58 gram po ashtu gjatë kontrollimit tek i akuzuari nën çorape janë gjetur edhe tre qese plastike me substancë narkotike të llojit kokainë në peshë prej 2.10 gram dhe pas bastisjes të shtëpisë është gjetur një fuli alumini me substancë narkotike marihuanë me peshë prej 0.99 gram si dhe një qese plastike me substancë narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 1.15 gram si dhe një thikë dhe boks hekuri ngjyrë e zezë.

- Këso dore ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK.

Andaj gjykata, konform dispozitave të nenit 7, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72, 79 në lidhje me nenin 267 par.1 të KP-ës, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumën prej 1300 euro si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve, në të cilin dënim me burgim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 11.01.2024 gjer më 07.03.2024.

Konform nenit 43 paragrafi 2 të KP obligohet i akuzuari që dënimin me gjobë ta paguajë në 6 këste mujore, dhe atë kësti i parë për pagesë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit ndërsa këstet vijuese në afat prej 30 ditëve nga pagesa e këstit paraprak.

Konform nenit 43 paragrafi 3 të KP nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën gjykata mund t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim ashtu që 20 euro gjobë do të llogaritet barabartë me një ditë burgim.

Konform nenit 44 të KP, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve i zëvendësohet me dënim me gjobë ashtu që të njëjtit i shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej 1.300 euro.

Nga i akuzuari konform nenit 267 paragrafi 5 të KP konfiskohen substancat narkotike dhe atë:

- Një qese plastike me substancë narkotik të llojit kokainë në peshë prej 0.58 gram
- Tre qese plastike me substancë narkotike të llojit kokainë në peshë prej 2.10 gram
- Një folie alumini me substancë narkotike të llojit marihuanë, në peshë prej 0.99 gram
- Një thikë me boks hekuri ngjyrë e zezë.
- Një qese plastike me substancë narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 1.15 gram, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Konform nenit 276 paragrafi 1 nën.paragraf 2.6 të KPP nga i akuzuari konfiskohet një thikë dhe një boks hekuri ngjyrë e zezë.

Konform nenit 113 të KPP të akuzuarit D. S., i kthehet telefoni Iphone 12 me ngjyrë të bardhë me SIM kartelë 046-196-706 me IMEI 3570768371516603 si dhe i kthehet automjeti "Audi A3" ngjyrë hiri me targa 04- 282-KH, pasi që nuk është mjet i kryerjes së veprës penale.

Të akuzuarit D. S., me datën 07.03.2024 i ndërprehet masa e paraburgimit.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore – paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej nga 50 euro si dhe të paguaj shumën me nga 50 euro për programin për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/I.nr.3/2024 të datës 01.03.2024 ndaj të akuzuarit D. S., nga Prizreni për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK.

Në lidhje me këtë çështje, gjykata e ka caktuar shqyrtimin fillestar më datën 07.03.2024 në të cilin shqyrtim fillestar i akuzuari pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit e ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas aktakuzës.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit. Po ashtu propozoi që të akuzuarit D. S., ti kthehet automjeti i markës "Audi A3" ngjyrë hiri me targa 04- 282-KH, me që në automjet nuk është gjetur ndonjë bunker që do të shërbente për vendosjen e narkotikut, respektivisht automjeti nuk është mjet i kryerjes së veprës penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit D. S., av. A.P., në fjalën e tij deklaroi se të mbrojturit të tij ia ka shpjeguar me kujdes përfitimet dhe pasojat që rrjedhin nga pranimi i fajësisë, se aktgjykimin nuk mund ta sulmojnë përkitazi me gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, ndërkaq sa i përket përfitimeve, ka njoftuar të pandehurin se me rastin e pranimit e fajësisë gjykata në kuptim të rrethanave lehtësuese mund të shqiptojë dënimin nën minimumin e posaçëm të paraparë për veprën penale në ngarkim. I mbrojturi i tij e ka kuptuar saktë atë që i ka thënë avokati e tij andaj e ftoi gjykatën që të pranojë pranimin e fajësisë dhe më pastaj të njëjtin të aprovojë. Ndërkaq sa i përket dënimit duke e ditur se të pandehurit i është gjetur sasi e vogël e substancave të dyshimta e luti gjykatën që me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së sanksionit penal, që në kuptim të nenit 70 par.3 nënpar.3.6, 3.10, 3.11 dhe 3.12 të konsideroj si rrethanë veçanërisht lehtësuese faktin se i pandehuri është i moshës së re, se nga mendjelehtësia për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, premtimin se më asnjëherë nuk do të përsërisë veprimet që çenojnë vlerat shoqërore, si dhe kërkim faljen nga i pandehuri. Andaj, në kuptim të nenit 71 par.1 nënpar.1.3 në lidhje me nenin 72 par.1 nënpar.1.4 të KP tja shqiptojë minimumin e paraparë me zbutje si dhe gjatë matjes së dënimit duke marr parasysh që për këtë vepër penale është paraparë dënim kumulativ, dënim me gjobë dhe me burgim, gjatë shqiptimit të dënimit me gjobë të ketë parasysh gjendjen e tij financiare.

I akuzuari D. S., në fjalën e tij deklaroi se është hera e parë që ka kryer vepër penale, se më herët nuk ka ra ndesh me ligjin, theksoi se jeton në bashkësi familjare vetëm me të ëmën, e cila është punëtore dhe se me rrogën e saj në shumën prej 450 euro, dhe me të ardhurat që fiton ai përfaqësisht 600 euro në muaj e mbajnë familjen dhe se eventualisht nëse shkon në burg do ti përkeqësohet edhe gjendja familjare dhe financiare dhe se nuk ka kush të kujdeset për të ëmën, i premtoi gjykatës që tani e tutje më nuk do të bie ndesh me ligjin.

Në bazë të lartëcekurave e duke e marrë parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari, i cili pranim i fajësisë është bërë konform nenit 242 të KPPK-së, pasi që i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, gjithashtu pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime teknike, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267, par. 1 të KPRK-së pasi që me

datë 11.01.2024 rreth orës 19:30 minuta në Prizren pa autorizim posedon me qëllim të shitjes substanca narkotike të llojit kokain dhe marihuanë në atë mënyrë që gjersa ishte duke e drejtuar automjetin “..... ” ngjyrë hiri me targa në magjistrale Prizren-Suharekë te semaforat në lagjen “Dardania” është ndaluar automjeti për kontroll, ashtu gjatë kontrollimit në mes të ulëseve është gjetur një qese plastike me substancë narkotike të llojit kokainë në peshë 0.58 gram po ashtu gjatë kontrollimit tek i akuzuari nën çorape janë gjetur edhe tre qese plastike me substancë narkotike të llojit kokainë në peshë prej 2.10 gram dhe pas bastisjes të shtëpisë është gjetur një fuli alumini me substancë narkotike marihuanë me peshë prej 0.99 gram si dhe një qese plastike me substancë narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 1.15 gram si dhe një thikë dhe boks hekuri ngjyrë e zezë, për çka edhe gjykata e shpalli fajtor dhe ia shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që vërtetoi se është penalo juridikisht përgjegjës.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimin, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimin, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimin, shkallën e përgjegjësisë dhe motivet nga të cilat është kryer vepra penale dhe si rrethanë lehtësuese morri parasysh pranimin e fajësisë, gjendjen e dobët ekonomike dhe pendimin e thellë, Ndërsa si rrethana rënduese gjykata morri parasysh llojin dhe sasinë e narkotikut të gjetur, ku kemi të bëjmë me substancë narkotike të llojit kokainë dhe marihuanë,-bimë narkotike të cilat sipas Ligjit për barënat narkotike supstanca psikotrope dhe precursor-Ligji nr.02/L-128,bëjnë pjesë në shtojcën-tabelën I,bimët, barënat narkotike dhe supstancat psikotrope me rrezikshmëri të lartë që nuk kanë përdorim në mjekësi dhe veterinë, veprimtaria e të cilave është e ndaluar në Kosovë, mënyrën e kryerjes së veprës penale e cila substancë- kokainë i është gjetur në automjetin e tij dhe nën çorape të tij e më pastaj substanca narkotike marihuanë edhe në shtëpinë e tij, faktin se përdorues të narkotikëve janë kryesisht të rinjtë e që ndikon negativisht në zhvillimin e tyre duke shfaqur rrezikshmëri për tërë shoqërinë, faktin se i akuzuari veprën penale e ka kryer për përfitime personale, pasi që shitja e këtyre substancave në treg do ti sillte përfitime të mëdha materiale andaj është mendimi i gjykatës se dënimi i këtillë i shqiptuar si në dispozitiv është në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimin i paraparë me nenin 38 të KPRK-së dhe se do të mundësoj një balancë të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarit, t’i mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit. Gjykata vendosi për këtë lloj të dënimin pasi që krijoi bindjen se i akuzuari në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tjera penale dhe se është mendimi i gjykatës se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimin që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe që të përmbahet, nga veprimet e tilla apo të ngjashme.

Vendimi për konfiskimin e sendeve është marr në kuptim të nenit 267 paragrafi 5 dhe 276 të KPRK-së në lidhje me nenin 269 dhe 270 të KPPK.

Vendimi për kthimin e sendit është marrë në kuptim të nenit 113 në lidhje me nenin 110 par. 13 dhe 18 të KPP-së pasi që nuk ka bazë për konfiskimin e tyre.

Vendimi i gjykatës për llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar me burgim, është marrë në përputhje me nenin 79 paragrafi 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 paragrafi 2 pika 2.6. lidhur me nenin 450 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimin e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 36 par.3 nën par.3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.8/L-109.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,
2024:069702, të datës 11.03.2024**

B. Profesional
Floridin Osmanaj

Kryetarja e trupit gjykues
Ajser Skenderi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykata.